

"PILATUS A.K SHPK"

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PILATUS A.K SHPK

NENI 1 DATA, EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit" me vullnetin e tyre të lirë të shprehur dhe në nënshkrimin e Statutit vendosen të formojnë shoqërinë:

I. THEMELIMI

Neni 1

1.1 Shoqëria "PILATUS A.K SHPK" themelohet nga ortaku i vetëm si më poshtë:

- Z. Agron Kryeziu, shtetas shqiptar, i biri i Skënderit, lindur më dt 09.02.1990, në Tiranë dhe banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me numër kartë identiteti J00209068F.

II. EMRI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2

Emri i shoqërisë

2.1 Emri i shoqërisë është "PILATUS A.K SHPK"

Neni 3

Forma ligjore

3.1 Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar (SHPK), në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendimin e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 4

Baza ligjore

4.1 Shoqëria "PILATUS A.K SHPK", do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", si dhe dispozitat e tjera të Legjislacionit Shqiptar në fuqi.



"PILATUS A.K SHPK"

Neni 5 Kohëzgjatja

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë për një kohë të pacaktuar.
5.2 Veprimtaria e Shoqërisë fillon që nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrës Kombëtare të Biznesit, Kavaje.

Neni 6 Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën, KAVAJE, zona kadastrale 2140, Kërçukaj.
6.2 Selia e shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Ortakeve të shoqërisë.
6.3 Shoqëria ka të drejtë drejtë të krijojë degë, filiale ose/dhe zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë vendit.
6.4 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera ekzistuese ose në të ardhmen do të zhvillojë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij me vendim të ortakeve të saj.

Neni 7 Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë vulën e saj që do të përdoret nga administratori.
7.2 Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga ortakët e shoqërisë, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.

Neni 8 Objekti

- 8.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:

Realizimi i prodhimeve dhe i stampave për stampimin e punimeve me vetrorëzinë, realizimi i fazës së stampimit të prodhimeve, me prerje të mbetjeve, pastaj lëmimi, luçidimi, llakimi; realizimi edhe i një faze të vetme të procesit të ndërtimit, realizimi e shitja e prodhimeve me vetrorëzinë dhe në vijim tregtimi i gjithë produkteve të realizuara. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash brenda dhe jashtë vendit për vete dhe për të tretë. Për të vetmin qëllim të arritjes së objektivit të lartpërmendur, shoqëria mund të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqëri të tjera, konsorciume ose kompani të cilat kanë objekte të ngjashëm apo analoge me të vetin dhe të kryejë të gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare. Në veçanti, shoqëria, mund të marrë në pronësi, uzufukt ose qera, kompani ose degë kompanish që operojnë në fushën e një ose më shumë prej veprimtarive të mësipërme. Gjithmonë, për të vetmin qëllim të arritjes së objektivit të lartpërmendur, shoqëria mundet gjithashtu të japë garanci, garanci mbi kreditë dhe depozitat, të lerë peng të mira dhe vlera të tundshme, të vendosë garanci hipotekore mbi të mirat e patundshme dhe të tundshme të regjistruara dhe të vendosë në përgjithësi çdo garanci të mundshme reale dhe personale.

Shoqëria duhet të kryejë çdo aktivitet që përfshihet në objektin e saj, në lidhje dhe që favorizon atë. Shoqëria duhet të respektojë të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse. Ajo përfshin standartet më të mira etike.

Objekti i shoqërisë mund të zgjerohet ose ndryshojë me vendim Asamblesë së Ortakëve të saj.



"PILATUS A.K SHPK"

Neni 9 **Kapitali**

- 9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) lekë, i nënshkruar i paderdhur.
9.2 Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë.

-Z. Agron Kryeziu 1 kuotë në masën 100% e kapitalit të shoqërisë me vlerë nominale 100,000 (njëqindmijë) lekë.

Neni 10 **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar**

- 10.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen lirisht nga ortaku i vetëm i shoqërisë.
10.2 Pjesët e kapitalit transferohen në rrugë trashëgimie pasi të jetë marrë vendimi i Ortakëve lidhur me kalimin e pjesëve të kapitalit tek trashëgimtarët.

Neni 11 **Zmadhimi /Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 11.1 Ortakët e shoqërisë mund të zmadhojnë ose zvogëlojnë kapitalin themeltar me vendim të tyre. Zvogëlimi i kapitalit themeltar do të kryhet brenda kufijve të lejuar nga ligji.

III. ORGANET E SHOQËRISË

Neni 12 **Asambleja e Ortakëve**

Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimor i shoqërisë.

- 13.1 Asambleja e Ortakëve drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Mbledhjet e Asamblesë janë të zakonshme.

Neni 13 **Asambleja e Zakonshme**

- 13.1 Asambleja e zakonshme vendos në çdo rrethanë në emër të shoqërisë. Ajo merr të gjitha vendimet (emërimi dhe shkarkimi i administratorit/ëve, miratimin e bilancit të shoqërisë, etj.), me përjashtim të atyre vendimeve që në bazë të ligjit ose Statutit janë në kompetencë të asamblesë së jashtëzakonshme.
13.2 Asambleja e zakonshme i merr vendimet nga ortakët e saj me 51% të votave.

Neni 14



"PILATUS A.K SHPK"

Thirrja dhe Përfaqësimi në Asamble

14.1 Mbledhje e Asamblesë së Ortakëve mund të thirret në çdo kohë nga :

- Administratori
- Ortakët e shoqërisë
- E të tjerë konform ligjit.

Neni 15

Njoftimi dhe Zhvillimi i Mbledhjeve

- 15.1 Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të njoftuar nga administratori/njëri prej administratorëve.
- 15.2 Njoftimi kryhet me shkrim, me telegram, me letër rekomande, dhe me postë tjetër të regjistruar, të pakten 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Neni 16

Marrja e vendimeve

- 16.1 Vendimet merren nga ortaket e saj me 51% të votave.

Neni 17

Administrimi

- 17.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose nga një grup administratorësh që caktohet nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- 17.2 Administratori nuk është detyrimisht ortak i shoqërisë.
- 17.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe të drejtojë punën e përditshme të shoqërisë, në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.
- 17.4 Administratori është solidarisht përgjegjës për veprimet e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët, personalisht ose duke caktuar zëvendës;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët, personalisht ose duke caktuar zëvendës, veçanërisht në marrëdhëniet me bankat e nivelit të dytë dhe institucionet e tjera të kreditit, për hapjen e llogarive bankare dhe marrjen e kredive.
 - Përgatitjen e mbledhjeve të Asamblesë të ortakëve;



"PILATUS A.K SHPK"

- Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit vetë ose emërimin e nje kontabilisti të miratuar ose të një eksperti kontabël;
- Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që ka;
- Lidh kontrata pune dhe i zgjidh ato sipas rastit;
- Zhvillon veprimtari të tjera të çdo natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj.

- 17.5 Shoqëria do të administrohet nga administratori z. Agron Kryeziu, i cila emërohet në këtë detyrë për një afat kohor prej 5 (pesë) vjetësh.

Neni 18 Viti financiar

- 18.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik ,duke filluar në 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 19 Bilanci. Mbjajta e kontabilitetit

- 19.1 Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjen e Asamblesë së ortakëve dhe i paraqitet organeve tatimore deri ne fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 19.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe ne monedhën Shqipëtare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë.
- 19.3 Shoqëria mund të marrë financime nga ortakët ,institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

Neni 20 Bilanci. Mbjajta e kontabilitetit

- 20.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e objektit të saj.
- 20.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo ushtrimori, pas pagimit të tativeve, mund të tërhiqen nga ortakët e shoqërisë.

Neni 21 Likuidimi

- 21.1 Shoqëria do të hyjë në procesin e likuidimit ,nëse :
- Gjendja ekonomike në Shqipëri nuk do të lejojë vazhdimin e veprimtarisë së shoqërisë;
 - Asambleja e Ortakeve, vendos të prishë shoqërinë.

"PILATUS A.K SHPK"

- 21.2 Në mënyrë që të ndërmarrë procedurat e likujdimit, Asambleja e Ortakëve emëron një likujdator ose një grup likujdatorësh.
- 21.3 Likujdatori/likujdatorët raportojnë mbi gjendjen e zërave të aktivitetit dhe të pasivitetit të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likujdimit dhe në kohën që nevojitet për përfundimin e tij.
- Në fund të këtij procesi, Asambleja e ortakëve shqyrton bilancin përfundimtar dhe mbyllet procedurës së likujdimit.


Neni 22
Dispozita mbyltese

- 22.1 Ky statut hartohet në 5 (pesë) kopje me fuqi të njëjtë ligjore në gjuhën Shqipe.

ORTAKU I VETËM

I
SHOQËRIË

Z. AGRON KRYEZIU



Kavajë, me 18.09.2023